



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Nr. 569/3 Prot.

Shkodër, më 29.09.2023

Lënda: Mbi Vendimin Nr. 65, datë 28.08.2023 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 8, shkronja “a”, të Urdhërit të Kryeministrit nr. 50, datë 12.04.2017 “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut”, të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brëndshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”, si dhe aneksin I, “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut”, pas administrimit të shkresës së ZABU Drin-Bunë nr. 297/1 prot., datë 21.09.2023 “Kthim përgjigje kërkesës për trajtim”, mbi VKB Vau Dejës Nr. 65, datë 28.08.2023 “Për dhënien në përdorim me afat 10 vjeçar sipërfaqen pyjore prej 0.141 ha për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetësore, shoqërore dhe për veprimtari turistike, kampingje, kënde lojrash, mjedise sportive, shplothëse e kulturore, etj., në ngastrën nr. 39/a të ekonomisë pyjore Gomsiqe”, se parcela përfshihet pjesërisht në brigjet e liqenit Vau Dejës, që është nën administrimin e Zyrës së Administrimit të Baseni Drin-Bunë.

Për sa citohet, referuar ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 1.2, shkronja “a”, neni 27, pika 5, neni 54, shkronja “e/1”, neni 55, pika 3 dhe 4, të ligjit nr. 57/2020 “Për pyjet”, neni 25, është tagër i Këshillit Bashkiak dhënia në përdorim e pronave me qëllim nxjerrjen e të ardhurave, praktikë e cila paraqet detyrim ligjor edhe trajtimin sipas ligjit të posaçëm Nr.111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar, duke zbatuar kriterin se kërkesat për veprimtari ndërtimore të cilat duhet të jenë për qëllime publike dhe mund të ushtrohet vetëm pasi të merret autorizimi i posaçëm nga organi kompetent për menaxhimin e burimeve ujore ZABU Drin-Bunë, sipas parashikimeve të nenit 67 të ligjit 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

P R E F E K T

Majlinda ANGONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI I BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 65 datë 28.08. 2023

“Dhënien në përdorim me afat 10 vjeçar sipërfaqen pyjore prej 0.141 ha “për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetsore, shoqërore dhe për vëprimtari turistike ,kampingje (kënde lojrash, mjedise sportive, shplodhëse, kulturore, etj”, në ngastrën nr.39/a të ekonominë pyjore Gomsiqe “.

Në mbështetje të nenit 9 pika 1.2, nenin 27 pika 5, nenin 54 shkronja “el”, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 57/2020, date 30.4.2020 “Për Pyjet”, neni 25, pika 49 e VKM nr. 433 datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, Udhëzimi i Ministrit të Mjedisit nr. 1 datë 09.06.2016 “Për rregullat ,procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik” *me shumicë votash, këshilli bashkiak:*

V E N D O S I

1. Miratimin e dhënies në përdorim të sipërfaqes prej 0.141 ha “për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetsore, shoqërore dhe për vëprimtari turistike ,kampingje (kënde lojrash, mjedise sportive, shplodhëse, kulturore, etj”, në ngastrën nr.39/a të ekonominë pyjore Gomsiqe” .

2. Afati i dhënies me qera të jetë 10 (dhjete) vjet me të drejtë rinovimi .

3. Vlera e dhënies me qira vjetore të jetë sipas VKM nr.559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore Pyjore”

4. Efektet: Jep impaktë pozitive tek komuniteti , sigurohen të ardhura të cilat kthehen në investime në fondin pyjor.

5. Ngarkohen Drejtoria e pyjeve, Turizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

KRYETARI KËSHILLIT

Ervis Shimaj



Sekretari i Këshillit Bashkiak

Ardian Çelepija

Miratuar me 18 vota

Vota Pro 18

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 01.09 2023